



| | |
|-------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIC OF KOSOVO | |
| KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS | |
| SKUPŠTINA REPUBLIKE KOSOVA | |
| ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO | |
| Zyra për Propozime dhe Përshtresa-Kancelarija za Predloge i Predstavka-Table Office | |
| Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No: | 06/254/D ₀ -187 |
| Nr. i faqëve Broj stranica No. pages: | |
| Data Datum Date: | 08.11.2017 |
| PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA | |


Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

| | | | |
|-----------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|------------|
| PËR / ZA / TO | z. Abelard Tahiri Ministër i Drejtësisë | DATE DATUM DATE | 08.11.2017 |
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Frashër Krasniqi Deputet i Grupit Parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Pyetja parlamentare:

- Z. Ministër, çfarë mendoni ju për procesin e montuar gjyqësor për terrorizëm, kundër aktivistëve të LVV? Personalisht, a keni informacione në lidhje me këtë rast?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

| | | | |
|-----------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|------------|
| PËR/ZA/TO | Shyqiri Bytyqi Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | DATE DATUM DATE | 08.11.2017 |
| | | Reference | |
| NGA/OD/FROM | Arbërie Nagavci, deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE! <i>Arbërie Nagavci</i> | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Zot. Ministër, me dt. 19 Tetor 2017 ju keni marrë vendim për emërimin e anëtarëve të rinjë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë Kosovare të Akreditimit . Kurse me 20 Tetor 2017 është njoftuar se me vendim tuaj janë emëruar kryetari dhe nënkryetari i përkohshëm i kësaj Agjencie.

Në lidhje me shkarkimin e Bordit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim me dt. 4 tetor i kisha parashtruar pyetje edhe Kryeministrit Haradinaj, por përgjigja e tij ishte krejtësisht sipërfaqësore dhe pa asnjë argumentim në lidhje me shkeljet e supozuara, me veprimet që do të ndërmerren në raport me ato shkelje dhe me njoftimin e publikut për gjetjet eventuale rreth performancës së anëtarëve të KSHC së AKA-së, apo veprimet në lidhje me “parregullsitë serioze në akreditimin në arsimin e lartë” si keni deklaruar në komunikatën zyrtare të ministrisë.

Pyetja parlamentare:

Zot. Ministër a mund të na njoftoni ju lutem se kur keni planifikuar të raportoni në këtë Kuvend në lidhje me vendimin tuaj për shkarkimin e të gjithë anëtarëve të Bordit të AKA-së pasi në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës , në nenin 7 , pika 5

parashihet se: “ Nëse më shumë se një e treta e anëtarëve të bordit zëvendësohen për çfarëdo arsye brenda një viti, Ministria duhet t’i raportojë këtë Kuvendit”.

Po ashtu ju lutem të na njoftoni se kur keni planifikuar që të raportoni për emërimin e anëtarëve të rinjë dhe kur do ta sillni për ratifikim në këtë Kuvend , konform nenit 7, pika 4 të po të njejtit Ligj.

Në fund a na njoftoni se si e arsyetoni shkeljen ligjore që Ju keni bërë duke emëruar kryetarin dhe nënkryetarin e këtij bordi, pasi në Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, gjegjësisht pika 2 e nenit 5 të kësaj rregulloreje precizon se “Zgjedhja e kryetarit të KSHC-së bëhet me shumicën e votave nga radhët e anëtarëve të KSHC-së”. Ndërkaq Neni 6 , pika 1 parasheh se “ KSHC në propozim të kryetarit nga radhët e veta zgjedh nënkryetarin e KSHC-së me vota të hapura” dhe pika 2 e po të njejtit nen parasheh se: “ Zgjidhja e nënkryetarit të KSHC-së bëhet me shumicën e votave nga radhët e anëtarëve të KSHC-së”.

Ju faleminderit.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
SKUPSTINA REPUBLIKE KOSOVA
ASSEMBLY OF REPUBLIC OF KOSOVO
Zyra për Propozime dhe Parashitresë-Kancelarija za Predloge i Predstavke-Table Office

Nr. Prot. 06/300/10-212
Sr. Prot.
Prot. No:

Nr. i faqeve
Broj stranica
No. pages: 21. 11. 2017
Data
Datum
Date:

SHQITINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

| | | | |
|-----------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|-------------------|
| PËR / ZA / TO | Uran Ismaili Ministër i Shëndetësisë | DATE DATUM DATE | 21.11.2017 |
| | | Reference | |
| NGA / OD / FROM | Besa Baftiu Deputete e GP Lëvizja VETËVENDOSJE! | | |
| SUBJEKTI PREDMET SUBJECT | Pyetje për përgjigje me gojë | | |

Në bazë të Rregullës 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Ministër ndonëse me rishikimin e buxhetit, falë ndërhyrjes së deputetëve të kuvendit u bë rikthimi i kontigjentit për sigurime shëndetësore në vlerë prej 11 milionë euro dhe u mundësua që këto mjete të shfrytëzohen për barna esenciale dhe trajtim jashtë vendit.

Pyetja parlamentare:

Z. Ministër ku është problemi që furnizimi me barna në spitalet tona nuk është përmisuar.